



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 119 datë 19.12.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	BASHKIA MALËSI E MADHE
Hetim administrativ, iniciuar nga	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Numri i procedurave të monitoruara	14 (katërmëdhjetë)
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	14 procedura “Të hapura”
Konstatimet kryesore	Janë audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit 14 (katërmëdhjetë) procedura prokurimi, ku ka rezultuar se: • Në 14 procedurat e prokurimit, Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, nëkundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. • Në 14 procedurat e prokurimit në fjalë, Autoriteti Kontraktor ka hartuar kritere të veçanta kualifikimi, të cilat, nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. • Në një prej procedurave të prokurimit të audituara, Autoriteti Kontraktor duhet të kishte kryer verifikime në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik i shpallurfitues, gjë që nuk është bërë, në kundërshtim me nenin 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Masat e marra	Referuar nenit 72, pika 1/dh/gj, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, APP vendosi: • Të penalizojë me gjobë 6 (gjashtë) punonjës, të evidentuar përgjegjës për mospërmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 28 dhe 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. • Të propozojë marrjen e masës disiplinore për 4 (katër) persona të evidentuar përgjegjës për mangësi të konstatuara në vendim.
----------------------	--